

Abstrakt

Në këtë temë jam munduar ta paraqes në mënyrë të drejtë analizën e martesave të sekseve të njëjta, personave transeksual dhe atyre interseksual përfshi edhe argumentet për dhe kundër. Ky studim ofron një analizë komparative të të drejtave martesore për personat e të njëjtës gjini, personat interseksualë dhe ata transeksualë, duke shqyrtuar argumentet për dhe kundër. Për të filluar, analizohet konteksti historik dhe zhvillimi ligjor i martesës në lidhje me këto grupime, duke theksuar ndryshimet që kanë ndodhur nën ndikimin e zhvillimeve shoqërore dhe ligjore. Pas kësaj, bëhet një shqyrtim i qasjeve juridike, morale, shoqërore dhe kulturore ndaj martesës për individët e këtyre grupeve, duke identifikuar sfidat dhe përparimet në nivel ligjor dhe shoqëror. Gjithashtu, analizohen argumentet për mbështetjen dhe kundërshtimin e barazisë martesore, duke i vënë në pah shqetësimet e ndryshme që shfaqen në debat. Përmes këtij abstrakti, synohet të ofrohet një pasqyrë e gjerë dhe informim për problematikën komplekse dhe aktuale të të drejtave martesore për këto grupe individësh. Përmes këtij hulumtimi ofron një kontribut të rëndësishëm në kuptimin dhe diskutimin e nevojave të drejtave të njeriut dhe barazisë në shoqëritë moderne. Studimi gjithashtu përfshin një analizë të thelluar të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe praktikave që do të siguronin respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave martesore për të gjitha këto grupe. Argumentet për dhe kundër barazisë martesore janë gjithashtu të shqyrtuara në këtë studim, duke u përpjekur të bëhet një pasqyrë e gjerë e debateve dhe shqetësimeve që rrethojnë këtë çështje të ndjeshme.

Fjalët kyçe: Martesa, legjislacionet, feja, argumentet, transeksual, interseksual.